

THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Trafikut Ajror, në Drejtorinë e Navigimit Ajror.

1. Çfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës, bazuar në profesionalizëm dhe meritë.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në kontrollin e trafikut ajror.

2. Detyrat e pozicionit të punës:

- a) Asiston Përgjegjësin e Sektorit për të zhvilluar/zbatuar Rregulloret e nevojshme për operim për Legjislacionin Bazë të Aviacionit dhe ti ndryshojë sipas nevojës, për të ruajtur nivelin e kërkuar të sigurisë në operim në ofrimin e shërbimit ATM dhe SAR në Shqipëri;
- b) Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të ndihmuar Përgjegjësin e Sektorit për zbatimin e SARPS përkatëse të përfshira në Aneksin 2, Aneksin 11 dhe Aneksin 12 të ICAO në Shqipëri dhe përditësimin e tyre sipas nevojës;
- c) Përgatit materialet udhëzuese dhe dokumente të tjera të nevojshme të lëshuara nga ICAO dhe/ose EASA në lidhje me ATM/ANS dhe SAR në Shqipëri dhe i përditësoni sipas nevojës sigurisë operationale të specifikuar nga ACAA;
- d) Përgatit me shkrim procedurat të sektorit në lidhje me çdo aktivitet që kryhet në DAN në lidhje me Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe SAR;
- e) Përgatit mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të Ofruesve të Shërbimeve të Trafikut Ajror, dhe objekteve të SAR, si manuali i inspektorëve, listat e kontrollit, formularët e anketimit dhe formularët e auditimit etj. dhe i vendos ato lehtësisht të disponueshme në Seksion. Kjo duhet të përfshijë pajisjet për inspektime efikase, vrojtim dhe auditime të certifikimit të ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror;
- f) Rishikon të gjithë manualët, procedurat e shkruara dhe manualin e lëshuar nga DAN në lidhje me ATM dhe SAR dhe i përditëson kur është e nevojshme;
- g) Asiston Përgjegjësin e Sektorit në marrjen e veprimeve të nevojshme për të autorizuar/certifikuar ofruesit e shërbimeve të trafikut ajror në Shqipëri në përputhje me rregulloret në fuqi, Standardet, procedurat e shkruara dhe direktivat e tjera përkatëse të nxjerra nga AAC;
- h) Asiston Përgjegjësin e Sektorit me veprimet e nevojshme për të lëshuar, rinovuar, ndryshuar, pezulluar ose anuluar Certifikatat/Autorizimet e Ofruesit të Shërbimeve të Trafikut Ajror.

3. Kërkesat dhe kushtet e pozicionit të punës që duhet të plotësojë kandidati

Kërkesat e pozicionit të punës:

- a) **Arsimimi:** Të paktën diplomë të nivelit “Bachelor” në Inxhinieri ose Shkenca Aviacioni, si dhe të ketë apo të ketë patur Liçensë të Kontrollorit të Trafikut Ajror;
- b) **Eksperiencia në punë:** Të ketë 5 vite eksperiencë në agjenci lidhur me mbikëqyrjen e sigurisë në Operim apo 5 vite ekperience në shërbimin e trafikut Ajror dhe 1 vit eksperiencë në mbikëqyrjen e sigurisë në operim përpara lëshimit të kredencialeve;
- c) **Gjuhë e huaj:** Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente).

Kushtet që duhet të plotësoj kandidati janë:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të zotërojë gjuhën shqipe dhe angleze, të shkruar dhe të folur;
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- e) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna nga institucionet publike apo private, ku ka ushtruar profesionin, e cila nuk është shuar sipas legjislacionit përkatës.

4. Dokumentacioni për dorëzim:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti;
- b) Formën e aplikimit të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti;
- c) Fotokopje të diplomës/diplomave;
- d) Fotokopje e librezës së punës;
- e) Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

5. Aftësi të kërkuara:

- a. **Etika dhe vlerat:** Të demonstrojë integritet, profesionalizëm dhe konfidencialitet. Të veprojë në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me vlerat themelore të institucionit;
- b. **Komunikimi:** Përcjell, merr dhe kupton në mënyrë efektive informacionin në mënyrë verbale apo të shkruar;
- c. **Zgjidhja e problemeve:** Zgjidh çështje të niveleve të ndryshme të kompleksitetit, paqartësisë dhe rrezikut brenda funksionit përkatës. Merr vendime në kohë duke marrë parasysh faktet, detyrat, qëllimet, kufizimet, rreziqet dhe pikëpamjet kontradiktore përkatëse;
- d. **Iniciativa:** Identifikon dhe trajton çështjet në mënyrë të pavarur, proaktive dhe këmbëngulëse për të arritur objektivat;
- e. **Aftësitë Teknike:** Zbaton dhe përmirëson njohuritë dhe aftësitë teknike për të kryer detyrat e ngarkuara.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet, si dhe njohuritë e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

- Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**;
- Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**.



Kandidati me rezultatet më të larta (por jo më pak se 70 pikë) shpallet fitues, ndërsa kandidatët që marrin të paktën 70 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen në listë pritje.

REZULTATET E VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Rezultate e vlerësimit të dokumentacionit.

Në datën **26/02/2024**, Autoriteti i Aviacionit Civil do të shpall një faqen e tij zyrtare të internetit, listën e kandidatëve të kualifikuar për intervistë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe vendin dhe datën e zhvillimit të intervistës.

Kandidatët të cilët nuk janë kualifikuar për intervistë mund të kërkojnë informacion me e-mail në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al, për aryet e moskualifikimit.

Shpallja e rezultatve të konkurimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë), Autoriteti i Aviacionit Civil, do të njoftojë individualisht me e-mail çdo kandidat për rezultatin e pikëve.

Kandidatët të cilët nuk janë dakort me rezultatin, kanë të drejtë të paraqesin ankim me e-mail pranë Autoritetit në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al. Afati i ankimit është **5 ditë** kalendarike nga data e njoftimit individual.

Autoriteti pas përfundimit të afatit të ankimit do të shpallë fituesin në faqen e tij të internetit.

APLIKIMI DHE DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni dhe të dorëzoni dokumentat e kërkuara (të skanuara) në adresën zyrtare rekrutime@acaa.gov.al.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë në shqyrtim dhe do të njoftojë për intervistë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e pozicionit të punës, si dhe kanë dorëzuar brenda afatit të caktuar për aplikim dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 22/02/2024.